



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. 6552 Prot

Shkodër, më 25 3 .2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin:

**“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE
ME QIRA NË ADMINISTRIMIN E BASHKISË SHKODËR PËR VITIN 2025”.**

Duke Ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,



KRYETAR

Benet Beci

Pr/Vendim 3 faqe

Relacion 2 faqe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë _____._____.2025

“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE ME QIRA NË ADMINISTRIMIN E BASHKISË SHKODËR PËR VITIN 2025”

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës _____._____.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar; nenit 30 pika 2, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” të ndryshuar; pika 11, 13 e VKM nr.522 datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”, VKB nr.1 datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore”, i ndryshuar; VKB nr.30 datë 03.06.2021 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6 për vitin 2021”, VKB nr.31, datë 03.06.2021 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom”, VKB nr.23 datë 10.5.2022 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare, e-mailin e datës 27.02.2025 të Institutit të Statistikave INSTAT mbi “Ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të konsumit”, Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër nr _____, datë _____, si dhe pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë.

VENDOSI:

- 1. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6, për vitin 2025 si më poshtë:**

Qiraja mujore e apartamentit A me sipërfaqe 56.8 m²

$3,316 + (3,316 \times 2,2\%) = 3,338 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit B me sipërfaqe 88.9 m²

$5,191 + (5,191 \times 2,2\%) = 5,305 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit C me sipërfaqe 96.1 m²
 $5,611 + (5,611 \times 2,2\%) = 5,734 \text{ Lekë/Muaj}$.

2. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom për vitin 2025, si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit 1+1 me sipërfaqe 30 m²
 $1,900 + (1,900 \times 2,2\%) = 1,941 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit 2+1 me sipërfaqe 40 m²
 $2,500 + (2,500 \times 2,2\%) = 2,555 \text{ Lekë/Muaj}$.

3. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare për vitin 2025 si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A 1+1 me sipërfaqe 33 m²
 $4,279 + (4,279 \times 2,2\%) = 4,373 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit B 1+1 me sipërfaqe 37 m²
 $4,729 + (4,729 \times 2,2\%) = 4,833 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit C 2+1 me sipërfaqe 55 m²
 $7,206 + (7,206 \times 2,2\%) = 7,364 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit D 2+1 me sipërfaqe 62 m²
 $8,107 + (8,107 \times 2,2\%) = 8,285 \text{ Lekë/Muaj}$.

4. Të ardhurat e mbledhura nga qiratë e fondit publik të banesave sociale me qira do të derdhen në llogarinë ekonomike të Bashkisë Shkodër me kodin nr. 7109600 me emërtimin “Qira e ndërtesës” (nga banesat sociale me qira).
5. Të ardhurat e depozituara nga qiratë e banesave sociale me qira përdoren nga strukturat përgjegjëse të administrimit të banesave sociale me qira për mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre dhe raportohet mbi përdorimin e fondit si pjesë e programit buxhetor nr. Programi 10661, Strehimi Social.
6. Niveli i qirasë i përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 është i vlefshëm deri me 31.01.2026.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



KRYETAR

Benet Beci

Zv. Kryetar

Teuta Gjeto

Drejtoria e Përgjithshme Juridike,

Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Jenis Vesha

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë,
Strehimit dhe Shëndetit Publik

Arllinde Krye

Drejtoria Juridike

Bilal Rexha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2025

RELACION

“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE ME QIRA NË ADMINISTRIMIN E BASHKISË SHKODËR PËR VITIN 2025”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Në zbatim të pikës 11 të VKM-së nr.522 datë 25.07.2019, niveli i qirasë së miratuar në Këshill Bashkiak përdoret deri në fund të muajit janar të vitit pasardhës. Çdo vit, niveli i qirasë së miratuar nga Këshilli Bashkiak shumëzohet me indeksin e ndryshimit të çmimeve të konsumit dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Sa më sipër, në zbatim të dispozitave ligjore, vlerat e qirasë për banesat sociale pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr.6, banesat sociale me qira për komunitetin rom si dhe për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare do të shumëzohen me indeksin e ndryshimit të çmimeve të konsumit, i cili, për vitin 2024 rezulton të jetë 2,2 %, sipas të dhënave periodike të publikuara nga INSTAT dhe e-mail i datës 27.02.2025 i Institutit të Statistikave INSTAT mbi “Ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të konsumit”,

1. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6, për vitin 2025 si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A me sipërfaqe 56.8 m²
 $3,316 + (3,316 \times 2,2\%) = 3,338$ Lekë/Muaj).

Qiraja mujore e apartamentit B me sipërfaqe 88.9 m²
 $5,191 + (5,191 \times 2,2\%) = 5,305$ Lekë/Muaj).

Qiraja mujore e apartamentit C me sipërfaqe 96.1 m²
 $5,611 + (5,611 \times 2,2\%) = 5,734$ Lekë/Muaj).

2. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom për vitin 2025, si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit 1+1 me sipërfaqe 30 m²

$$1,900 + (1,900 \times 2,2\%) = \mathbf{1,941 \text{ Lekë/Muaj}}.$$

Qiraja mujore e apartamentit 2+1 me sipërfaqe 40 m²

$$2,500 + (2,500 \times 2,2\%) = \mathbf{2,555 \text{ Lekë/Muaj}}.$$

3. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare për vitin 2025 si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A 1+1 me sipërfaqe 33 m²

$$4,279 + (4,279 \times 2,2 \%) = \mathbf{4,373 \text{ Lekë/Muaj}}.$$

Qiraja mujore e apartamentit B 1+1 me sipërfaqe 37 m²

$$4,729 + (4,729 \times 2,2 \%) = \mathbf{4,833 \text{ Lekë/Muaj}}.$$

Qiraja mujore e apartamentit C 2+1 me sipërfaqe 55 m²

$$7,206 + (7,206 \times 2,2 \%) = \mathbf{7,364 \text{ Lekë/Muaj}}.$$

Qiraja mujore e apartamentit D 2+1 me sipërfaqe 62 m²

$$8,107 + (8,107 \times 2,2\%) = \mathbf{8,285 \text{ Lekë/Muaj}}.$$

4. Të gjitha të ardhurat që mblidhen nga qiratë e fondit publik të banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër do të derdhen në llogarinë ekonomike të Bashkisë Shkodër me kodin nr. 7109600 me emërtimin “Qira e ndërtesës” (nga banesat sociale me qira).

5. Të ardhurat e depozituara nga qiratë e banesave sociale me qira përdoren nga strukturat përgjegjëse të administrimit të banesave sociale me qira për mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre dhe raportohet mbi përdorimin e fondit si pjesë e programit buxhetor nr. Programi 10661, Strehimi Social.

Në këto kushte, për realizimin e detyrimeve ligjore, kërkojmë nga ana juaj të miratoni “Masat e qirasë për Banesat Sociale për vitin 2025”, të llogaritura sipas VKM nr.522, datë 25.07.2019.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin!



Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit, Shëndetit Publik

Arliando Krupa

INSTAT: Kthim Përgjigje

From info <info@instat.gov.al>
Date Thu 2/27/2025 9:21 AM
To Glivi Kacerri <Glivi.Kacerri@bashkiashkoder.gov.al>

KUJDES: Ky është një email i ardhur nga jashtë adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-të ose bashkëlidhjet nëse nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni dërguesit.

I nderuar përdorues,

Në përgjigje të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se INSTAT se ndryshimi mesatar vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit për vitin 2024 është 2,2 %. Ky tregues llogaritet në nivel kombëtar dhe nuk disponojmë të dhëna të ndara sipas bashkive specifike.

Faleminderit,

INSTAT
Institute of Statistics
Rruga Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Albania
ZIP Code, 1017
E- mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

From: Glivi Kacerri <Glivi.Kacerri@bashkiashkoder.gov.al>
Sent: Tuesday, February 25, 2025 11:13 AM
To: info <info@instat.gov.al>
Cc: Teuta Qyteza <Teuta.Qyteza@bashkiashkoder.gov.al>; Arlinda Kruja <Arlinda.Kruja@bashkiashkoder.gov.al>
Subject: Kërkesë për informacion
Importance: High

KUJDES: Ky email është dërguar nga jashtë organizatës. Mos klikoni linqet ose hapni materialin në attach nëse nuk e njihni dërguesin dhe procedoni vetëm nëse e dini se përmbajtja është e sigurt.

Përshëndetje! Uroj që të jeni mirë!

Në kuadër të programeve sociale të strehimit që Bashkia Shkodër ka në zbatim dhe konkretisht me qëllim që të miratojmë me Vendim të Këshillit Bashkiak , nivelin e qirasë të banesave sociale me qira , kërkohet informacion në lidhje me “indeksin e ndryshimit të çmimeve të konsumit te vitit 2024 për Bashkinë Shkodër”.

Duke shpresuar për një përgjigje sa më të shpejtë nga ana juaj për efekt afatesh!

Duke Ju uruar punë të mbarë!

Glivi Kacerri